

## Partizani/ Te kuqte i bejne oferte Mentor Zhdrelles

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 05 Dhjetor 2013 22:34

---



Partizani e ka ndare mendjen te perforcohet edhe ne janar me lojtare nga Kosova. Se fundmi, mediat kosovare kane zbuluar se te kuqte i kane bere nje oferte mesfushorit te talentuar Mentor Zhdrella. Lojtari eshte per momentin pjese e skuadres se Hysit ne Superligen e Kosoves dhe veshtire se mund te largohet por Partizani e ka marre seriozisht dhe ka ne plan ta provoj me cdo kusht afrimin e tij. Zhdrella eshte nje nga me te miret ne Kosove dhe te kuqte e Hasan Likes e kane te nevojshem fantazine e tij per mesfushen.